REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

NJOFTIM PËR PARAKUALIFIKIM

Në zbatim të nenit 21 të ligjit 9663, datë 18.12.2006, "Për konçesionet", të kreut IX të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.01.2007 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së konçesioneve", i ndryshuar dhe të VKM nr. 874, datë 14/12/2011 "Për përcaktimin e autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit dhe operimit të autostradës Milot-Morinë" si dhe publikimin e ftesës për ofertë të shpalljes së dokumentave parakualifikuese në datë 19 Dhjetor 2011 nga ku rezultuan se u paraqitën 5 (pesë) subjekte në procedurën parakualifikuese të zhvilluar në Ministrinë e Puneve Publike dhe Transportit në datë 27.02.2012 ora 12:00, ju njoftojmë si më poshtë:

Subjektet e mëposhtme të listuara sipas rendit alfabetik ju shqyrtuan dhe ju vlerësuan dokumentacioni ligjor, ekonomik dhe teknik dhe u konstatua se për secilin subjekt dokumentacioni u gjend në përmbushje të plotë të kritereve të kërkuara dhe si rezultat subjektet pjesëmarrëse janë klasifikuar për fazën e parë të kualifikimit:

- Shoqëria "Autostrada Breschia -Verona –Viçenza-Padova" s.p.a.
- Shoqëria "Hochtief Solutions PPP";
- Bashkimi i shoqërive "J&P Avax" dhe "Egis";
- Bashkimi i shoqërive **"**Strabag" dhe "Intertoll";
- Bashkimi i shoqërive "Vinci Concession s.a.s" dhe "Aktor s.a";

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, me anë të "Njoftim për parakualifikim", fton të gjithë subjektet parakualifikuese të sipërpërmendura të depozitojnë propozimet e tyre për fazën e dytë të procedurës konkuruese ashtu si edhe parashikohet në ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për konçesionet", neni 16. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit me anë të një njoftimi të dytë, do të krijojë mundësinë për subjektet e parakualifikuara të marrin informacion për ecurinë e procedurës konkuruese dhe për përshpejtimin e fazës së dytë për projektin konçesionar "Për dhënien me konçesion të shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit dhe operimit të autostradës Milot-Morinë".